



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2022:234789

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05546785

**C. nr. 277/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, përmes gjyqtarit Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. Th. nga ....., të cilin me autorizim e përfaqëson Shefqet Rexha, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim Alban Hashani, Jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për mos nxjerrjen e vendimit – kontratës mbi emërimin në pozitën e Drejtorit, në SHFMU “17 Shkurti”, në fshatin Muçivërc, Komuna e Kamenicës dhe kompensimin e diferencës së pagave, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datën 20.02.2024 mori, ndërsa më datën 04.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Th. nga ..... dhe **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që të veproj sipas rekomandimit të Komisionit Intervistues - Vlerësues, të datës 20.07.2022, për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës, të institucionit edukativo – arsimor dhe aftësues, për emërimin e kandidatit të rekomanduar, tani paditësit A.Th. nga ....., në pozitën e drejtorit të SHFMU “17 Shkurti”, në fshatin Muçivërc, Komuna e Kamenicës, brenda afatit prej 7 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

**II. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë, e paditësit A. Th. nga ....., përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që të njëjtët t’ia kompensojë diferencën e pagës, duke filluar që nga data e rekomandimit të Komisionit Intervistues – Vlerësues, dhe atë që nga data 01.08.2022 e deri më datën 29.02.2024, respektivisht për 19 muaj, nga 73.45 euro për muaj, e në shumë të përgjithshme prej 1,395.68 euro, brenda afatit prej 7 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm, **NË TËRËSI SI E PABAZUAR.**

**III. OBLIGOHET** e paditura, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 374.00 euro, brenda afatit prej 7 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

## **A r s y e t i m**

### **1. Rrjedha e procedurës**

Paditësi A. Th. nga ....., përmes të autorizuarit të tij Shefqet Rexha, avokat nga Kamenica, më datën 09.11.2022, në këtë Gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për mos nxjerrjen e vendimit – kontratës mbi emërimin në pozitën e Drejtorit, në SHFMU “17 Shkurti”, në fshatin Muçivërc, Komuna e Kamenicës dhe kompensimin e diferencës së pagave.

### **2. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

I autorizuari i palës paditëse, avokati Shefqet Rexha nga Kamenica, në seancën përgaditore dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë, duke kërkuar nga gjykata që të obligohet DKA-Komuna e Kamenicës, që të nxjerrë vendim për emërimin në pozitën e drejtorit të SHFMU “17 Shkurti” në fshatin Muçivërcë Komuna e Kamenicës për paditësin A.Th.. Pasiqë i njejtë ka deklaruar se paditësi A. Th. në konkursin e hapur nga vetë DKA- Komuna e Kamenicës për Drejtor të Shkollave, nga komisioni vlerësues është vlerësuar si kandidati më i suksesshëm dhe është rekomanduar tek Kryetari i Komunës për t’u emëruar si drejtor në Shfmu “17 Shkurti” në fshatin Muçivërcë Komuna e Kamenicës. Mirëpo i autorizuar i palës paditëse ka theksuar se edhe pas rekomandimit nga komisioni vlerësues të kandidatit, tani paditësit A. Th. për tu emëruar drejtor në shkollën e lartëcekur, sipas të njejtit ende Kryetari i Komunës nuk ka nxjerrur vendim për emërimin e të njejtit, me çrast ka theksuar se Kryetari i Komunës nuk e ka respektuar udhëzimin administrative me numër 151/2020 të nxjerrur nga MASHT. Tutje ka deklaruar se paditësi pasi që nuk është emëruar si drejtor, i është drejtuar me kërkesë Kryetarit të Komunës për të kërkuar informata se për çfarë arsye i njejtë nuk është emëruar ende si drejtor, mirëpo i njejtë nuk ka marrur përgjigje dhe pas kësaj është detyruar të paraqesë padi në Gjykatë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore. Pas të gjitha këtyre, në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që të Obligohet e paditura që ta emëroj paditësin si drejtor në shkollën e lartëcekur si dhe të njejtit t’i ja bëjë kompenzimin e diferencës së pagës në shumën e përgjithshme prej 1,395.68 Euro. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 374.00 Euro.

I autorizuari i palës së paditur, Alban Hashani, jurist nga Kamenica, në seancën përgaditore dhe gjatë shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se padia e paditësit duhet të hedhet poshtë si e palejuar për shkak të lëshimit të afatit për t’i shterrur mjetet e brendshme juridike tek punëdhënësi dhe të paraqitjes së padisë në gjykatë konform nenit 74 të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe neni 78 të

Ligjit të Punës, e mbi këtë bazë ka kërkuar nga gjykata që padia e paditësit të refuzohet në terësi si e palejuar dhe e paafatshme. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

### **3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: vendimin me numër 1026, datës 14.07.2023, i lëshuar nga Kryetari i Komunës së Gjilanit, kërkesa me shkrim e datës 22.08.2022, e paditësit A. Th., drejtuar Kryetari të Komunës e Kamenicës, deklarata e Kryetarit të Kshillit të Prindërve, A. Th., formularët A, B, C, D, rreth formimit të Komisionit, intervistimit të kandidatëve, vlerësimit të kandidatëve gjatë intervistës, rangimi i kandidatëve të vlerësuar dhe rekomandimi i kandidatëve të sukseshem, të gjitha formular këto rreth konkursit të hapur nga DKA, Komuna e Kamenicës, për drejtor të shkollave në këtë Komunë, konkursi për plotësimin e vendeve të lira të vendit të punës, i datës 17.06.2022, i hapur nga DKA – Komuna e Kamenicës, për Drejtor të shkollave, kërkesa me shkrim e datës 03.10.2024, e paditësit A. Th., drejtuar Kryetari të Komunës së Kamenicës, kontrata e punës në emër të A. Th., e datës 12.12.2017, njoftimi me numër 79, i datës 13.07.2022, i lëshuar nga Komuna e Kamenicës, procesverbali i Inspektoratit të Arsimit, i datës 17.12.2021, dëgjimi i dëshmitarit Sh. R. nga ..... dhe paditësit A. Th. në cilësinë e palës.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha sëbashku, konform dispozitës së nenit 8, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Gjykata, ka gjetur se për paditësen kontestues ka qenë fakti i mosveprimit të DKA-së, në Komunën e Kamenicës, sipas rekomandimit të Komisionit Intervistues - Vlerësues, të datës 20.07.2022, për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës, të institucionit edukativo – arsimor dhe aftësues, ndërsa për të paditurën kontestuese ishte baza juridike dhe afatshmëria e kërkesëpadiës së paditësit. Andaj, Gjykata këto pretendime i ka shqyrtuar dhe vlerësuar si në vijim:

#### **3.1. Provat materiale**

Në bazë të konkursit për plotësimin e vendeve të lira të vendit të punës, të datës 17.06.2022, i hapur nga DKA – Komuna e Kamenicës, për drejtor të shkollave, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti është hapur në bazë të Ligjit për Zyrarët Publikë nr.06/L-114, Kapitulli V, neni 67, 68, dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.151/2020, Vendimit Sh.02, nr.18601, i datës 16.06.2022, Vendimi Sh.02 nr.18615, i datës 16.06.2022, Vendimi Sh.02 nr.18697, i datës 16.06.2022, për rishpalljen e konkursit për plotësimin e vendeve të lira të punës, me titullin e punës: Drejtor në Shkollën e Mesme të Lartë në Komunën e Kamenicës, Drejtor në Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta Komunën e Kamenicës, Drejtor në IP “Filizat” në Komunën e Kamenicës, me llojin, numrin e pozitës, titullin e punës, Gradën/Koeficientin, oret e punës dhe kohëzgjatjen e emërimit, qëllimin e vendit të punës, detyrat e vendit të punës, kushtet që duhet të plotësohen për vendin e punës, dokumentet e nevojshme, të përshkruara në të njëjtin konkurs

të lartëcekur. Më njoftimin për kandidatët e interesuar për marrjen e aplikacioneve, dhe dorëzimin e tyre të plotësuar në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Kamenicë.

Në bazë të njoftimit me numër 79, i datës 13.07.2022, i lëshuar nga Komuna e Kamenicës, gjykata vërtetoi faktin se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, të Ligjit për Zyrarët Publik nr.06/L-114, dhe Udhëzimit Administrativ nr.05/2021, ka nxjerrë njoftimin më të cilin ka njoftuar kandidatët të cilët kanë aplikuar dhe i kanë plotësuar kushtet për t'u ftuar në intervistë sipas datës dhe orës, të përcaktuar në këtë njoftim, për konkursin e Rishpallur RN00009243, për pozitat Drejtor në Shkollat Filllore të Mesmë të Ulëta dhe Shkollat Filllore të Mesmë të Larta Mikse si dhe Shkollat e Mesme të Larta Profesionale. Ndërsa kandidatët të cilët kanë aplikuar dhe nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore janë njoftuar për paraqitjen e tyre në Njësinë Për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, brenda afatit prej 3 ditësh, nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Në bazë të formularëve C, D, E, dhe F, rreth formimit të Komisionit, intervistimit të kandidateve, vlerësimit të kandidateve gjatë intervistës, rangimi i kandidatëve të vlerësuar dhe rekomandimi i kandidatëve të sukseshëm, formulare këto rreth konkursit të hapur nga DKA, Komuna e Kamenicës, me numër 02/18764, të datës 17.06.2022, për drejtor të shkollave në këtë Komunë, gjykata vërtetoi faktin se:

Në bazë të formularit C, gjykata vërtetoi faktin se kandidati për drejtor në SHFMU “17 Shkurti”, fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, tani paditësi A. Th., është intervistuar nga Komisioni Intervistues.

Në bazë të fushave të vlerësimit që hyjnë në kuadër të formularit C, gjykata vërtetoi faktin se të tre antarët e Komisionit Vlerësues, Sh. R., A. S. dhe F.K., e kanë vlerësuar me pikë, kandidatin për drejtor në SHFMU “17 Shkurti”, fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, tani paditësi A. Th..

Në bazë të formularit D, gjykata vërtetoi faktin se të tre antaret e Komisionit Vlerësues, Sh.Rr., A. S. dhe F. K., i kanë grumbulluar pikët për rangimin e kandidatit sipas pikëve të fiturara gjatë intervistimit.

Në bazë të formularit E, gjykata vërtetoi faktin se Komisioni Vlerësues, i përbërë nga Sh. R., A.S. dhe F. K. dhe në prani të vëzhguesve pa të drejtë vlerësimi dhe atë A. K. mësimdhënës dhe A. Th.nga Këshilli i prindërve, më datën 20.07.2022, në bazë të rezultateve të vlerësimit të përgjithshëm, e kanë ranguar si kandidatin me më së shumti pikë të vlerësuar gjatë procesit të vlerësimit dhe e kanë rekomanduar kandidatin A. Th., tani paditësin të Kryetari i Komunës së Kamenicës, për emërimin e të njëjtit për në pozitën e drejtorit të SHFMU “17 Shkurti”, fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, për periudhën 4 vjeqare.

Në bazë të formularit F, gjykata vërtetoi faktin se anëtari vëzhgues gjatë intervistimit të kandidatëve për përzgjedhjen e drejtorit në SHFMU “17 Shkurti”, fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, A. K. mësimdhënës, ka vlerësuar se procedurat e zhvillimit të intervistimit kanë qenë në rregull, pyetjet e parashtruara kanë qenë në mënyre korrekte dhe se kandidati i ka dhënë përgjigjet e duhura.

Në bazë të kërkesës me shkrim, të datës 22.08.2022, të paditësit A. Th., drejtuar Kryetarit të Komunës së Kamenicës, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti me anë të kërkesës me shkrim ka kërkuar nga Zyra e Kryetarit në Komunën e Kamenicës, Z.K. R., rezultatet e testit për pozitën e Drejtorit në SHFMU “17 Shkurti”, fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, në intervistën e mbajtur më datë 20.07.2022 dhe një kopje të vlerësimit dhe rekomandimit nga Komisioni Intervistues nga DKA dhe përfaqësuesit e MASHT-it.

Në bazë të kërkesës me shkrim, të datës 03.10.2022, të paditësit A. Th., drejtuar Kryetarit të Komunës së Kamenicës, Z.K. R., gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka kërkuar të informohet nga Kryetari i Komunës, për t’i dhënë arsye se përse nuk është emëruar në pozitën e Drejtorit në SHFMU “17 Shkurti”, në fshatin Muçivërc, Komuna e Kamenicës, meqë Komisioni Vlerësues, në intervistën e mbajtur më datë 20.07.2022, e ka vlerësuar si kandidatë më të suksesshmin dhe se ka rekomanduar që i njëjti, pra A. Th., të bëhet Drejtor i shkollës së lartëcekur.

Në bazë të deklaratës së Kryetarit të Këshillit të Prindërve, A. Th., në SHFMU “17 Shkurti”, në fshatin Muçivërc, Komuna e Kamenicës, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka deklaruar se në cilësinë e vëzhguesit si anëtar i Këshillit të prindërve, pa të drejtë vlerësimi, procedura e konkursit dhe intervistës së mbajtur me datë 20.07.2022, me kandidatin për Drejtor, A.Th., është zhvilluar me rregull sipas ligjit. Po ashtu, nga deklarata e të njëjtit, është vërtetuar se Komisioni Vlerësues është përbërë nga Kryetar i Komisionit Sh. Rr., dhe antarët e tjerë të Komisionit A. S., F. K. përfaqësues i MASHT, A. K. përfaqësues nga Këshilli i Arsimitarëve, si dhe është vërtetuar se A. Th., si kandidat i vetëm për pozitën e Drejtorit në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “17 Shkurti”, në fshatin Muçivërcë, Komuna e Kamenicës, ka konsideruar se ishte i suksesshëm në intervistë e cila dëshmohej edhe përmes incizimit nëse paraqitet.

Në bazë të kontratës së punës në emër të A. Th., të datës 12.12.2017, gjykata vërtetoi faktin se se punëmarrësi A. Th., nga ....., ka lidhur kontratë nga marrëdhënia e punës, më punëdhënsin Drejtoria e Arsimit, Komuna e Kamenicës, me titullin e pozitës Drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “17 Shkurti”, në fshatin Muçivërcë, Komuna e Kamenicës, me Kohëzgjatje nga data 11.12.2017 deri më 10.12.2021, (katër vite), me pagë mujore kalendarike 562.25 euro bruto, orët e punës në javë 40 (30 orë menaxheriale dhe 10 orë mësimdhënie), me përshkrimin e të drejtave dhe detyrimeve si në Kontratë, e nënshkruar nga Kryetari i Komunës B.S. dhe A. Th. më datë 11.12.2017.

Në bazë të vendimit me numër 1026, të datës 14.07.2023, i lëshuar nga Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, gjykata vërtetoi faktin se në bazë të vlerësimit nga Komisioni rekrutues, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASH), nr.151/2020, neni 9, paragrafi 1, Kryetari i Komunës, ka nxjerrë vendim për emërimin e kandidatëve të suksesshëm për pozitën e Drejtorit dhe atë në Shkollën e Mesme të Lartë Ekonomike “Marin Barleti” në Gjilan, kandidati Fatlume Behluli, 80.66 pikë. Në Shkollën e Mesme të Lartë Gjimnazi Shoqëror “Zenel Hajdini” në Gjilan, kandidati J. R., 85.3 pikë. Në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Livoq i Ulët, kandidati E. B., 77 pikë. Në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Ibrahim Uruqi” në fshatin Bresalc, kandidati B. S., 67.5 pikë. Në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Vuk Karagjigj” në fshatin Shillovë, kandidati E. B., 64.33 pikë. Me

udhëzimin për të drejtën e ankesës me shkrim, në Komisionin e Ankesave në kuadër të DKA-së, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

### **3.2. Deklarata e dëshmitarit Sh. R.**

Dëshmitari Sh. Rr., nga ....., gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 20.02.2024, ka deklaruar se ka qenë Kryesues i Komisionit intervistues për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës SHFMU “17 Shkurti”, në fshatin Muqivercë, Komuna e Kamenicës, dhe se nuk i kujtohet saktësisht data kur është realizuar intervista për Drejtor të shkollës së lartëcekur, mirpo e din se ka qenë fundi i muajit korrik i vitit 2022. Tutje ka shtuar se Komisioni Intervistues ka qenë i përbërë prej 3 anëtarëve dhe aty kanë qenë, vet si Kryetar i Komisionit si perfaqësues i DKA, perfaqësuesi i Shkollave A. S., Profesor, dhe perfaqësuesi nga MASHT, emri i të cilit nuk i është kujtuar. Tutje ka deklaruar se Kuvendi Komunal zakonisht e ka aprovuar përberjen e Komisionit me rastin e konkurseve të DKA-së. Po ashtu, dëshmitari ka theksuar se në fillim të konkursit të lartëcekur, kanë qenë dy kandidat për drejtor të Shkollës “17 Shkurti” në fshatin Muqivercë, Komuna e Kamenicës, dhe ata kanë qenë A. Th. dhe B.S., ndërsa ka shtuar se, më vonë me shqyrtimin e dokumenteve B.S., është eliminuar nga gara për shkak se nuk i ka pasur dokumentet në rregull me rastin e aplikimit, pra, jo të kompletuara, dhe sipas të njëjtit në garë ka mbetë vetëm A. Th.. Dëshmitari ka shtuar se A. Th. në bazë të dokumenteve të paraqitura i ka plotësuar kushtet formale për të kandiduar për Drejtor të Shkollës, tutje ka shtuar se A. Th., e kanë intervistuar anëtarët e Komisionit, i njëjti e ka kaluar me sukses intervistën sepse i ka arritur pikët e nevojshme. Gjithashtu, ka theksuar se pas perfundimit të intervistës, anëtarët e Komisionit Intervistues, njëzëri e kanë rekomanduar A. Th., tek Kryetari i Komunës së Kamenicës, për tu emëruar Drejtor i Shkollës “17 Shkurti” në fshatin Muqivercë, Komuna e Kamenicës, dhe këtë rekomandim e kanë bërë në formë të shkruar, ndërsa edhe pas rekomandimit të tyre, Sipas të njëjtit, Kryetari i Komunës, nuk e ka emëruar asnjërin prej kandidateve që ne i kemi rekomanduar, dhe se në atë Shkollë, ende nuk ka drejtor të rregullt por, është vetëm ushtruesi i detyres, që rreth 2 vite. Po ashtu, e ka njoftuar Gjykatën se periudha kohore e cila është e përcaktuar me Udhëzim Administrativ, prej momentit të perfundimit të afatit për aplikim në konkurs publik, e deri te dhënia e informacionit për kandidatet se janë përzgjedhë apo jo, si më të suksesshmit zgjatë 45 dite dhe sipas të njëjtit Komisioni e ka respektuar këtë afat në tërësi.

### **3.3. Deklarata e paditësit A.Th.**

Paditësi A. Th. nga ....., gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, të datës 20.02.2024, ka deklaruar se i njëjti ka aplikuar për Drejtor të Shkollës “17 Shkurti” në fshatin Muqivercë, Komuna e Kamenicës, ndërsa është intervistuar nga Komisioni Intervistues më datë 20.07.2022, dhe se ka deklaruar se për Drejtor të Shkollave mbahet vetëm intervista me gojë dhe nuk ka test me shkrim sipas Udhëzimit Administrativ. Po ashtu, i njëjti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë ankesë ndaj antarëve të Komisionit dhe se të njëjtit i kanë respektuar të gjitha procedurat dhe afatet e konkursit. Intervista e tij ka zgjatë 35 minuta dhe pas perfundimit të intervistës kishte kuptuar që ka qenë i vetmi në garë për drejtor në shkollën e lartëcekur, pasi që sipas të njëjtit kandidati tjetër ishte diskualifikuar nga Komisioni. Tutje ka shtuar pas perfundimit të intervistës, ka kërkuar informata në DKA, se përse nuk po publikohen rezultatet e intervistes

për drejtor, ndërsa të njëjtit, Kryetari i Komsionit Sh. R., i kishte thënë se ne e kemi bërë punën tonë, ju jeni i perzgjedhur nga Komsioni dhe se je i rekomanduar për Drejtor të Shkollës “17 Shkurti” në fshatin Muqivercë, Komuna e Kamenicës, dhe këtë rekomandim e kanë dërguar te Kryetari i Komunës së Kamenicës. Pas kësaj, paditësi ka theksuar se Kryetarit të Komunës i është drejtuar me kërkesë me shkrim me datën 22.08.2022, mirpo i njëjti nuk i ishte përgjigjur fare, pastaj i është drejtuar Inspektoratit të Arsimit në Gjilan, me email, me kërkesën se përse nuk po publikohen rezultatet për pozitën e Drejtorit, edhe të njëjtit nuk i ishin përgjigjur fare, prap ka bërë kërkesë në Komunën e Zyrës së Kryetarit dhe Zyrës së Personelit, më datën 03.10.2022, dhe të njëjtit nuk i janë përgjigjur, dhe pas kësaj ka deklaruar se ka paraqitur padi brenda afatit ligjor në gjykatë. Në fund ka shtuar se mandati i Drejtorit në një shkollë është 4 vjet sipas Udhëzimit Administrativ dhe se ka kërkuar nga gjykata që t’ia aprovoj kërkesëpadinë dhe të emerohet Drejtor i Shkollës “17 Shkurti” në fshatin Muqivercë, Komuna e Kamenicës.

#### 4. Baza juridike

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 78 paragrafi 1, të Ligjit të Punës, me Nr. 03/L-2012, ku përcaktohet se *“I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”* ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se *“Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”*, si dhe në bazë të paragrafit 3, të po të këtij neni *“Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”*, poashtu në dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës së lartëcekur, përcaktohet se *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”*, si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 34 paragrafi 2 të Ligjit për Zyratë Publik (Ligji Nr. 06/L – 114), ku përcaktohet se *“Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë”*, ndërsa në paragrafin 4 të po këtij neni përcaktohet se *“Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 dite dhe jo më i gjatë se 15 ditë kalendarike”*. Gjithëashtu duke u bazur në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 151 /2020, për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, ku përcaktohet se *“3. Komisioni përzgjedhës për institucionet arsimore që janë në varësi të komunës ka c këtë përbërje: 3.1. Dy anëtarë të komunës të cilët propozohen nga DKA dhe miratohen nga Kuvendi Komunal. Anëtari i parë është i punësuar në DKA, ndërsa anëtari i dytë i propozuar nga DKA është njeri nga këta tre: ekspertë i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit arsimor me performancë të lartë, përfaqësues nga këshilli i prindërve në*

nivel komune me kualifikim dhe ekspertizë në fushën e edukimit. Anëtari i komisionit i punësuar në DKA, njëherit është edhe kryesues i komisionit; 3.2. Një anëtar nga MASH, i cili përcaktohet nga MASH, pasi që ka marrë njoftim zyrtar, email zyrtar nga DKA; 3.3. Dy përfaqësues të Këshillit drejtues nga IEAAP, në cilësinë e vëzhguesve, një prind dhe një mësimdhënës.”, ndërsa në nenin 8 të po të njejtit udhëzim administrativ, përcaktohet se “Procedura zhvillohet nga komisioni përzgjedhës si në vijim: përgaditja për intervistim, intervistimi dhe prezantimi i konceptit të Planit Zhvillimor nga kandidatët e përzgjedhur, vlerësimi, përgaditja e raportit me rekomandime për kandidatin/en më të suksesshëm”, si dhe në nenin 9 të këtij udhëzimi administrativ ku përcaktohet se “1. Kryetari i komunës, në bazë të rezultateve të vlerësimit nga komisioni, aprovon rekomandimin e komisionit, duke nxjerrë vendim për emërimin drejtorit/zëvendësdrejtorit/eshës të IEAAP. 2. Sekretari i MASH, në bazë të rezultateve të vlerësimit nga komisioni, aprovon rekomandimin e komisionit duke nxjerrë vendim për emërimin e drejtorit/zëvendësdrejtorit/eshës të Qendrës Burimore. 3. Drejtori i AAAPARRr, në bazë të rezultateve të vlerësimit nga komisioni, aprovon rekomandimin e komisionit duke nxjerrë vendim për emërimin e drejtorit/zëvendësdrejtorit/eshës të Qendrës së Kompetencës. 4. Vendimi për emërim bëhet brenda tri ditëve pune nga pranimi i rekomandimit për kandidatin e suksesshëm drejtor/zëvendësdrejtor/eshë. 5. Vendimi për emërim nuk nxirret për asnjë person i cili ka bërë shkelje sipas ligjit të arsimit parauniversitar neni 35, paragrafi 7” gjykata erdhi në përfundim se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar në ligj dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa, gjykata vendosi sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase duke e pasur parasysh faktin se paditësi nuk i ka ofruar gjykatës prova të mjaftueshme dhe bindëse përmes së cilave do t’a bindte gjykatën dhe do ta bënte të besueshme të drejtën e tij, se të njëjtit i takon e drejta e kompensimit të diferencës së pagës, të cekur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, obligim ky për paditësin, i paraparë me dispozitën e nenit 7 paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku përcaktohet se “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, e aq më tepër paditësi nuk ka arritur që gjatë shqyrtimit kryesor t’a bindë gjykatën dhe t’i provoj faktet me prova relevante mbi të cilat e ka paraqitur një kërkesë të tillë, obligim ky për paditësin, i paraparë me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1, të po këtij ligji, ku përcaktohet se “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”. Andaj, Gjykata vendosi që në munges të bazës juridike, të refuzoj si të pa bazuar pjesën e kërkesëpadiës të paditësit për kompensimin e diferencës së pagës të cekur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

##### **5. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës**

Duke i pasur parasysh provat materiale, dhe deklaratën e vet paditësit, të cekura si më lartë, dhe pas analizimit dhe vlerësimit me kujdesë të tyre, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit A. Th., është pjesërisht e bazuar në ligj, ashtu që në bazë të këtij konstatimi gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit përmes së cilës ka kërkuar



realizmin e kërkesave të lartëcekura, t'a aprovoj si pjesërisht si të bazuar, sikurse në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Fillimisht, Gjykata e ka shqyrtuar pretendimin e palës së paditur se kinse paditësi A. Th., nuk i ka shtjerrur mjetet e brendshme juridike tek punëdhënësi DKA – Komuna e Kamenicës, dhe se padia e të njëjtit është e parakohshme, dhe pas vlerësimit të provave materiale, ka ardhur në përfundim se paditësi i ka respektuar procedurat paraprake për t'a kërkuar realizimin e të drejtës së tij tek punëdhënësi DKA – Komuna e Kamenicës, respektivisht i ka shtjerrur mjetet e brendshme juridike tek punëdhënësi, ashtu siq kërkohet me dispozitën e nenit 88, të Ligjit për Zyrëtarët Publik dhe dispozitën e nenit 78 të Ligjit të Punës, duke i paraqitur dy herë kërkesë me shkrim Zyrës së Kryetarit të Komunës së Kamenicës, duke i kërkuar të njëjtit informata se përse nuk është vepruar sipas rekomandimit të Komisionit Vlerësues, me rastin e rekomandimit të kandidatëve për drejtor të shkollave në Komunën e Kamenicës, sipas konkursit për plotësimin e vendeve të lira të punës, të datës 17.06.2022, i hapur nga DKA – Komuna e Kamenicës, respektivisht Gjykata këtë fakt e ka vërtetuar në bazë të provave materiale dhe atë dy kërkesave me shkrim të datës 22.08.2022 dhe të datës 03.10.2022, të paditësit A.Th., drejtuar Kryetarit të Komunës së Kamenicës, madje Gjykata ka vërtetuar se këto kërkesa janë paraqitur brenda afatit ligjor të parapara me dispozitat e lartëcekura, ngase Komisioni Vlerësues, tani paditësin A.Th., me datën 20.07.2022, e ka rekomanduar tek Kryetari i Komunës së Kamenicës, për t'u emëruar si Drejtor në shkollën “17 Shkurti” në fshatin Muqivërc, Komuna e Kamenicës, e të cilin fakt gjykata e ka vërtetuar në bazë të provës materiale formulari E, i cekur si më lartë, e rrjedhimisht gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi pasi që i ka shtjerrur mjetet juridike tek punëdhënësi, brenda afatit ligjor e ka paraqitur edhe padinë në Gjykatë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, për shkak të mosveprimit të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, konform Udhëzimit Administrativ me numër 151/2020, të nxjerrur nga MASHT.

Po ashtu, Gjykata ka ardhur në përfundim që sipas deklarimeve nga i autorizuari i palës së paditur, gjatë gjithë fazave të procedurës nuk ka qenë kontestuese çështja se paditësi A. Th., ka qenë kandidati i rekomanduar nga Komisioni Vlerësues, si më i suksesshmi për t'u emëruar drejtor i shkollës Shfmu “17 Shkurti” në fshatin Muqivërc, Komuna e Kamenicës, por kontestuese nga i njëjti ka qenë vetëm afatshmëria e padisë së paditësit, të cilin fakt gjykata e ka vërtetuar si më lartë.

Ndërsa, faktin se paditësi A. Th., ka qenë kandidati i cili i ka kaluar me sukses fazat e rekrutimit për tu rekomanduar nga Komisioni intervistues – vlerësues, që të emërohet drejtor në shkollën Shfmu “17 Shkurti” në fshatin Muqivërc, Komuna e Kamenicës, sipas konkursit për plotësimin e vendeve të lira të punës, të datës 17.06.2022, i hapur nga DKA – Komuna e Kamenicës, Gjykata e ka vërtetuar në bazë të provave materiale, respektivisht në bazë të formularëve C, D, E, dhe F, rreth formimit të Komisionit, intervistimit të kandidatëve, vlerësimit të kandidatëve gjatë intervistës, rangimi i kandidatëve të vlerësuar dhe rekomandimi i kandidatëve të suksesshem, ashtu që në bazë të formularit E, gjykata vërtetoi faktin se Komisioni Vlerësues, i përbërë nga Sh.R., A. S. dhe F. K.dhe në prani të vëzhguesve pa të drejtë vlerësimi dhe atë A. K. mësimdhënës dhe A. Th. nga Këshilli i prindërve, më datën 20.07.2022, në bazë të rezultatëve të vlerësimit të përgjithshëm, e kanë ranguar si kandidatin me

më së shumti pikë të vlerësuar gjatë procesit të vlerësimit dhe e kanë rekomanduar kandidatin A.Th., tani paditësin të Kryetari i Komunës së Kamenicës, për emërimin e të njëjtit për në pozitën e drejtorit të SHFMU “17 Shkurti”, fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, për periudhën 4 vjeqare.

Por, në anën tjetër Gjykata ka vërtetuar se Kryetari i Komunës së Kamenicës, nuk ka vepruar konform nenit 9, paragrafi 1 dhe 4, të Udhëzimit Administrativ me numër 151/2020, të nxjerrur nga MASHT, ku përcaktohet se *“Kryetari i komunës, në bazë të rezultateve të vlerësimit nga komisioni, aprovon rekomandimin e komisionit, duke nxjerrë vendim për emërimin drejtorit/zëvendësdrejtorit/eshës të IEAAP. 4. Vendimi për emërim bëhet brenda tri ditëve pune nga pranimi i rekomandimit për kandidatin e suksesshëm drejtor/zëvendësdrejtor/eshë”*, madje e paditura nuk ka arritur t’a vërtetoj me asnjë provë të vetme qoftë materiale apo personale se paditësin A.Th., e kanë njoftuar me shkrim, rreth kërkesave të tij të cekura si më lartë, madje, Gjykata ka ardhur në përfundim se e paditura me asnjë provë të vetme nuk e ka vërtetuar, respektivisht arsyetuar, se përse kandidatin A. Th., të rekomanduar nga Komisioni Vlerësues, nuk e ka emëruar drejtor të Shkollës “ 17 Shkurti” në fshatin Muçivërcë, Komuna e Kamenicës, konform nenit 9 të Udhëzimit Administrativ të cekur si më lartë, e në këtë mënyrë sipas vlerësimit të Gjykatës, i’a ka cenuar të drejtën paditësit për t’u informuar rreth të drejtës së tij të pretenduar, respektivisht i’a ka mohuar të drejtën e tij të fituar në bazë të Komisionit Vlerësues, për rekrutimin e drejtorëve të Shkollave në Komunën e Kamenicës sipas konkursit të lartëcekur.

Andaj, Gjykata pas analizimit të dispozitave të lartëcekura, respektivisht nenit 9 të Udhëzimit Administrativ me numër 151/2020, të nxjerrur nga MASHT, të cekur si më lartë, ka ardhur në përfundim se në rastet kur Komisioni Vlerësues e rekomandon një kandidatë për tu emëruar në pozitën e drejtorit të shkollës, Kryetari i Komunës si organ kompetent, duhet të veproj konform rekomandimit të Komisionit Vlerësues dhe t’a aprovoj rekomandimin e Komisionit Vlerësues, rrjedhimisht Kryetari i Komunës nuk ka diskrecion që ta vlerësoj përsëri kandidatin se duhet apo nuk duhet të emërohet si drejtor, përveq në rastet kur Kryetari i Komunës, dyshon për ndonjë vepër të kundërligjshme, e në të cilat raste i njëjti duhet t’i inicioj procedurat ligjore për dyshime eventuale, ndërsa në anën tjetër e paditura në asnjë mënyrë nuk ka pretenduar e as nuk e ka provuar se në rastin konkret ka pasur dyshime për manipulim të procesit të rekrutimit për përzgjedhjen e drejtorëve e as për kandidatin e rekomanduar tani paditësin A. Th., mbi këtë bazë gjykata ka ardhur në përfundim se Kryetari i Komunës së Kamenicës, është dashur të veproj konform nenit 9 të Udhëzimit Administrativ të cekur si më lartë, dhe t’a emëroj kandidatin e rekomanduar A. Th., për drejtor në Shkollën SHFMU “17 Shkurti”, fshati Muçivërc në Komunën e Kamenicës.

Për më tepër, Gjykata vlerëson se në rastet kur nuk ka dyshime për keqpërdorime gjatë fazave të rekrutimit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave, e që në rastin konkret në asnjë mënyrë nuk është vërtetuar se ka pasur keqpërdorime eventuale në njërën anë, ndërsa mosveprimi i Kryetarit të Komunës konform Udhëzimit Administrativ të cekur si më lartë, dhe sipas rekomandimit të Komisionit Vlerësues si në rastin konkret, në anën tjetër paraqet shpërfillje dhe mos respektim të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, e rrjedhimisht në situatat e tilla rrezikohet edhe siguria juridike e qytetarëve për të kandiduar për pozita të tilla, si në rastin

konkret. Andaj, Gjykata vlerëson se në çdo rastë, domosdoshmërisht duhet të respektohen ligjet e aplikueshme dhe aktët nënligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, Gjykata e mori për bazë edhe dëshminë e dëshmitarit Sh. R., i cili gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 20.02.2024, ka deklaruar se ka qenë Kryesues i Komisionit intervistues për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës SHFMU “17 Shkurti”, në fshatin Muqivercë, Komuna e Kamenicës, dhe se sipas të njëjtit, kandidati tani paditësi A. Th., në bazë të dokumenteve të paraqitura i ka plotësuar kushtet formale për të kandiduar për Drejtor të Shkollës, të njëjtin e kanë intervistuar anëtarët e Komisionit, i njëjti e ka kaluar me sukses intervistën duke i ka arritur pikët e nevojshme. Gjithashtu, ka theksuar se pas perfundimit të intervistës, anëtarët e Komisionit Intervistues, njëzëri e kanë rekomanduar A. Th., tek Kryetari i Komunës së Kamenicës, për tu emëruar Drejtor i Shkollës “17 Shkurti” në fshatin Muqivercë, Komuna e Kamenicës, dhe këtë rekomandim e kanë bërë në formë të shkruar, ndërsa edhe pas rekomandimit të tyre, sipas të njëjtit, Kryetari i Komunës, nuk e ka emëruar, e të cilës deklaratë Gjykata i’a fali besimin e plotë dhe e mori për bazë me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, ngase dëshmia e tij ishte e sinqertë, e plotë dhe në harmoni të plotë me provat e tjera materiale, e aq më tepër se i njëjti ka qenë edhe kryetar i komisionit vlerësues dhe ndaj të njëjtit nuk ka pas vërejtje as e paditura gjatë punës së tij në komisionin vlerësues në bazë të konkursit për plotësimin e vendeve të lira të vendit të punës, të datës 17.06.2022, i hapur nga DKA – Komuna e Kamenicës, për drejtor të shkollave.

Gjykata, vendosi sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe e refuzoj si të pa bazuar në ligj pjesën e kërkesëpadisë së paditësit A. Th., përmes së cilës ka kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që t’ia kompensoj diferencat e pagave, sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, ngase Gjykata vlerëson se të njëjtit nuk i takon kompenzimi monetar, për punën të cilën paditësi asnjëherë faktikisht nuk e ka kryer, si drejtor i shkollës, e aq më tepër që i njëjti nuk ka pasur marrëdhënie punë të themeluar me të paditurën në pozitën e drejtorit të shkollës, rrjedhimisht paditësi përmes padisë e ka kontestuar fazën e fundit të rekrutimit – përzgjedhjes së tij si drejtor i shkollës.

#### **6. Shpenzimet e procedurës kontestimore**

Gjykata, lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore vendosi duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1, të LPK-së, si dhe në bazë të Tarifës të Odës të Avokatëve të Kosovës, dhe e detyroj të paditurën, që paditësit, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 374.00 euro. Shpenzime këto të shkaktuara si në vijim; dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro dhe në emër të përfaqësimit në 2 (dy) seanca gjyqësore, dhe atë për secilën veç e veç nga 135.00 euro, respektivisht 270.00 euro.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartëcekura, e lidhur me dispozitën e nenit 143, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C. nr. 277/2022, i datës 04.04.2024**

**G j y q t a r i,**  
Artan Abazi, d. v

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas datës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.